

Për: Z.Pandeli Majko  
Ministër i Shtetit për Diasporën  
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 1.1000  
Tiranë, Republika e Shqipërisë

Prishtinë, Republika e Kosovës  
10 shkurt 2019

I nderuar Ministër Majko,

Germin vlerëson lartë punën tuaj për Diasporën Shqiptare, por edhe bashkëpunimin që keni me organizatën tonë. Përtej aktivitetit tuaj si Ministër, ne kemi një respekt të jashtëzakonshëm për punën tuaj për shqiptarët që nga lufta në Kosovë, dhe si një njeri i drejtë e me etikë të lartë.

Duke patur këtë konsideratë, po ju shkruajmë lidhur me disa shqetësime që janë ngritur në prag të Samitit të Diasporës dhe që shpresojmë që ju t'i kuptoni si qëllim-mira nga ana jonë, bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit, të nënshkruar vitin e kaluar në mes të Germin dhe Ministrit të Shtetit për Diasporën.

#### **Shqetësimet tona janë të përmbledhura në këto katër çështje:**

- Organizimi i Samitit të Dytë të Diasporës dhe miratimi i Strategjisë Kombëtare për Diasporën nuk i përfshiu pjesëtarët e Diasporës, dhe është e nevojshme që këto organizime dhe punë në të ardhmen të krijojnë një kulturë më të madhe të bashkëpunimit në mes institucioneve qeveritare dhe Diasporës Shqiptare;
- Alokimi i një buxheti aq të madh, prej 67 milionë lekësh (mbi €500,000), për një ngjarje tre-ditore është i tepërt kur ka nevojë për përpjekje tjera dhe shhfrytëzim më të mirë të parave të taksapaguesve përmes investimit të vazhdueshëm, dhe jo vetëm shpenzimeve në marrëdhëniet me Diasporën shqiptare; dhe
- Samiti i Dytë i Diasporës Shqiptare jep më shumë ndjesinë se është një Samit për vetëm shtetasit e Shqipërisë e jo për Diasporën Shqiptare - në program ka shumë pak ose pothuasje fare përmbajtje për të tërhequr shqiptarët të cilët nuk kanë lindur në Shqipëri;
- Këshilli Koordinues i Diasporës të ri-shqytohen dhe të krijohet një Këshill global pan-shqiptar për Diasporën, i përbërë nga të gjitha shtetet ku ka shqiptarë (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi, Lugina e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovcit).

#### **Ajo se çfarë ne rekomandojmë është:**

- Të rritet numri i paneleve dhe seancave plenare në mënyrë që ky Samit të përqëndrohet më shumë në diskutim substancial për të rritur angazhimin e drejtpërdrejtë të anëtarëve të Diasporës në Samit;
- Qeveria e Shqipërisë të rishikojë alokimin e buxhetit, të anulojë dekorimet e rrugëve, dhe të ulë ndjeshëm kostot e qirasë, skenografisë, gala mbrëmjes dhe programit - edhe nëse kjo nënkupton që ngjarja të zhvillohet në një vend më të vogël; po ashtu

shpenzimet lidhur me Samitin e Dytë të Diasporës, por edhe alokimet lidhur me angazhimin e Diasporës në përgjithësi të vazhdojnë të bëhen publike;

- Një pjesë e konsiderueshme e buxhetit të Samitit të Diasporës të ri-kanalizohet drejt programeve dhe angazhimeve afatgjata në buxhetin e Agjencisë për Diasporën (që ka buxhetin vjetore më të vogël se Samitin) të sigurojë një bashkëpunim më të mirë me Diasporën në të ardhmen;
- Diaspora të përshihet si partnere në organizimin e ngjarjeve që kanë të bëjnë me të, tani dhe në të ardhmen, dhe mos të jenë vetëm mysafirë, pasi që roli i qeverisë në shekullin XXI duhet të jetë lehtësimi i bashkëpunimeve e jo vetëm zbatimi i projekteve;
- Çdo organizim/Samit i ardhshëm të udhëhiqet nga Diaspora me mbështetje të Qeverisë së Shqipërisë, Kosovës dhe vendeve të tjera që marrin pjesë në këto organizime, për të siguruar një Samit të vërtetë Pan-Shqiptar;
- Ministria të hartojë një deklaratë zyrtare që do të nënshkruhet në fund të Samitit duke deklaruar se ky do të jetë Samiti i fundit i Diasporës i organizuar nga qeveria dhe se në të ardhmen ajo do të punojë formalisht me diasporën për të organizuar konferenca dhe samite;
- Të ngritet një grup punues prej 10-15 anëtarësh gjatë apo menjëherë pas Samitit për të udhëhequr vazhdimësinë e punës. Ky grup punues duhet të ketë përbërje të barabartë në mes të përfaqësuesve të Qeverisë, Diasporës dhe gjithashtu të përfshijë përfaqësues të Qeverive të Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi të angazhuar në çështjet e diasporës;
- Të vihet në pritje krijimi i Këshillit për Diasporën derisa grupi punues i lartëpërmendur të mund të shqyrtojë tërësisht të gjitha alternativat në mënyrën më gjithëpërfshirëse;
- Procesi dhe nominimet për Këshillin Koordinues Koordinativ të ri-shqytohen dhe të krijohet një Këshill global pan-shqiptar për Diasporën, i përbërë nga të gjitha shtetet ku ka shqiptarë (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi, Lugina e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovcit).
- Zbatimi dhe rishikimi i Strategjisë Kombëtare për Diasporën dhe Planit të Veprimit të bëhet në bashkëpunim të ngushtë me këtë grup punues; dhe
- Mediat sociale të përdoren për të promovuar dialog serioz me Diasporën shqiptare dhe jo vetëm për transmetimet/promovime qeveritare.


Shpresojmë që do ju do t'i merrni në konsideratë këto shqetësime dhe rekomandime dashamirëse dhe të bëhen disa përmirësime deri në Samit dhe pas Samitit.

Shumë faleminderit, dhe mbesim në dispozicion tuajin për diskutim të mëtutjeshëm,

Sinqerisht,



Liza Gashi, Drejtoreshë Ekzekutive  
GERMIN



Mark Kosmo, Kryesues i Bordit GERMIN